



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3024/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan në nivel institucional, për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
  - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
- III. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar, BSc, 180 ECTS, maksimumi 200 studentë për vit akademik.
  - Arsimi Fillor, BA, 240 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
  - Arsimi Parashkollor, BA, 240 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik.
  - E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- IV. Akreditohen programet e studimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
  - Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
  - Juridiko-Penal, LLM, 60 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik.

1/4

- Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor, MA, 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.

V. Nuk akreditohet programi i studimit Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan:

- Menaxhim dhe Ndërmarrësi, MSc, 120 ECTS, me specializime: 1. Menaxhment dhe Ndërmarrësi, 2. Menaxhim Financiar.

VI. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

VII. Obligohet Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

I. Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Basri Ahmedi Lindita Nebiu Hyseni Kastriot Dermaku
2	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Arben Mustafa Lutfi Zharku Arben Sahiti
3	Arsimi Fillor, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Nergjivane Krasniqi Bajram Kosumi Shpresë Qamili Musa Ajeti
4	Arsimi Parashkollor, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Mensur Neziri Nevrije Bislimi Ismajli Emin Krasniqi Teuta Agaj
5	E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS Ri-akreditim	Nysret Demaku Refik Kryeziu
6	Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 60 ECTS Akreditim	Merxhan Avdyli
7	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MSc, 120 ECTS Akreditim	Artan Dermaku Ragmi Mustafa
8	Juridiko-Penal, LLM, 60 ECTS Akreditim	Fejzullah Hasani

9	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor, MA, 60 ECTS, Akreditim	Vogëlushe Kurteshi
10	Menaxhim dhe Ndërmarrësi, MSc, 120 ECTS ,me specializime: 1. Menaxhment dhe Ndërmarrësi, 2. Menaxhim Financiar. Akreditim	Naim Mustafa Shefket Jakupi Gezim Tosuni

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar tri vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 12.03.2021, 14.05.2021 dhe më 18.05.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peteer Normak, Dietmar Payer, Christopher Bohlen, Dhurata Shehri, Goce Naumovski, Josip Burušić, Elene Jibladze, Ketj Tsojniashvili, Josip Balen dhe Laura Palac.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm ( Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5), e përmbush pjesërisht një (1).
2. Për programin e studimit Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht katër (4), e përmbush pjesërisht një (1).
3. Për programin e studimit Arsimit Fillor, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), i përmbush pjesërisht dy (2).
4. Për programin e studimit Arsimit Parashkollor, BA, 240 ECTS – nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), i përmbush pjesërisht dy (2).
5. Për programin e studimit E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), i përmbush substancialisht gjashtë (6).
6. Për programin e studimit Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6), e përmbush pjesërisht një (1)
7. Për programin e studimit Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) substancialisht katër (4), e përmbush pjesërisht një (1).
8. Për programin e studimit Juridiko-Penal, LLM, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht shtatë (7).
9. Për programin e studimit Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor, MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), i përmbush pjesërisht tri (3).
10. Për programin e studimit Menaxhim dhe Ndërmarrësi, MSc, 120 ECTS ,me specializime: 1. Menaxhment dhe Ndërmarrësi, 2. Menaxhim Financiar, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), i përmbush substancialisht dy (2), i përmbush pjesërisht katër (4).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

